



Vdes njëri nga të plagosurit me armë zjarri në rrugën Klinë – Gjakovë

LAJME

LAJMI I FUNDIT

Më afër lexuesit.

28/04/2022 22:21

f

t

l

Para pak minutash u raportua për të shtëna armësh në rrugën Klinë – Gjakovë.

Nga Policia e Kosovës kanë konfirmuar për lajmi.net se nga ky rast, janë plagosur dy persona, mirëpo që njëri prej tyre nuk ka arritur t’u mbijetojë plagëve dhe për pasojë ka vdekur.

Fadil Gashi, zëdhënës i Policisë për Rajonin e Pejës, ka thënë për lajmi.net se dy të plagosurit janë dërguar në spital, mirëpo që njëri prej tyre nuk ka arritur t’u mbijetojë plagëve.

“Në 20:43 minuta policia është njoftuar se ka të shtëna me armë zjarri dhe dyshohet për të plagosur. Me të arritur në vend të ngjarjes, është konstatu se dy persona janë të lënduar. Janë dërguar në Qendrën e mjekësisë familjare pastaj janë dërguar në emergjencën e Pejës. Pas pak kohe, mjeku kujdestar e ka konfirmuar vdekjen e njëres viktimë”, tha Gashi. **/Lajmi.net/**

Artikuj të ngjashëm

April 29, 2022

Vdekje e dyshimtë në Prishtinë, një femër gjendet pa shenja jete...

April 29, 2022

Aktakuzë ndaj gjakovarit: Shiste 100-euro false për 20 euro origjinale

April 29, 2022

Lushtaku insiston në shkarkimin e ambasadorit Berishaj: Po dëmtohet imazhi i...

April 29, 2022

Kurti reagon për zgjedhjen e Abazoviqit kryeministër: Mezi pres të punojmë...

April 29, 2022

Policia kryen bastisje në Skenderaj, konfiskon aparate të lojërave të fatit

April 29, 2022

Britania e Madhe: Putini mund të shpallë Luftën e Tretë Botërore...